



## **AKT - THEMELIMI**

**PER KRIJIMIN E SHOQERISE ANONIME**

**NE PRONESI PRIVATE**

**“ ILIRIA HOLDING SH. A.” TIRANE**

### **I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

#### **Neni 1**

**Themeluesi Hajdin Sejdia krijon shoqerine anonime ne pronesi private me mjetet vetjake , me karakter Holding (Aksionar ) , si ortak i vetem .**

#### **Neni 2**

**Shoqeria anonime nga neni 1 i ketij akti do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin Shoqeria Anonime ne Pronesi Private “Iliria Holding Sh.A” - Tirane (me poshte e quajtur “Shoqeri” ).**

#### **Neni 3**

**Shoqeria ka statutin e personit juridik.**

#### **Neni 4**

**Selia e Shoqerise eshte ne Rruga “Ded Gjonluli” Pll.5 , Shk.1, Ap.7 ne Tirane.**

## Neni 5

Shoqeria ka vulen e saj.

Vula ka forme te rrumbullaket me madhesi te zakonshme , rreth e perqark se ciles eshte i shkruar teksti : Shoqeria "Iliria Holding S.A." , ne mes eshte shkruar fjala "Tirane - Albanija".

## Neni 6

Shoqeria ka intestimin e saj.

Intensimi ka forme te katerkendeshit kendedrejte , me madhesi te zakonshme, ne skajin e siperm te te cilit eshte shkruar teksti : "Shoqeria "ILIRIA HOLDING SA" Tirane Albania , ne mes eshte shkruar shenja "Nr" me nje vize me shenjen "19\_\_\_\_\_".


## Neni 7

Shoqeria synon shtimin e te ardhurave ne valute te vendit dhe te huaja, rritjen e eksportit dhe pakesimin e importit ; rritjen e llojshmerise te mallrave te konsumit dhe te mallrave te tjera ; krijimin e vendeve te reja te punes ; modernizimin e objekteve ekzistuese ose ngritjen e objekteve te reja ekonomike te leverdisshme e me teknologji te perparuar , si dhe futjen e metodave bashkekohore per organizimin e drejtimin e prodhimit , te sherbimeve. etj.

## Neni 8

Ne perputhje me Statutin qe i bashkangjitet ketij Akti si pjese perberese e tij Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- Investime per objekte te rendesishme ne Republiken e Shqiperise ne fusha te ndryshme te ekonomise duke perfshire nxjerrjen, perpunimin dhe shitjen e mineraleve si edhe ne turizem etj ,  
Shoqeria do te veproje jo vetem si investuese e drejtperdrejte , por edhe si ndermjetese per firmat e tjera te huaja. Ne investime mund te perfshihen, sipas rastit, edhe "Engeneering- Konsalting and know how";





**- Kryerjen e transaksioneve te ndryshme ne kuadrin e eksport-importit shqiptar per cdo mall (bujqesor, industrial, pasuri natyrore etj.) jo vetem per mallra te gatshme e lende te para, por edhe per mallra gjysem te gatshme qe kerkojne perpunim dhe shitje te metejshme ;**

**- Sjelljen ne Republiken e Shqiperise te mallrave te ndryshme te konsumit te gjere e industrial si ne rolin e shitesit, ashtu edhe me konsignacion. Per kete Shoqeria mund te cele njesi shitjeje te specializuara ne qytete te ndryshme te vendit , ku do te shitet me leke dhe me monedhe te huaj te konvertueshme ;**

**- Tranzitimin e mallrave ne magazina te specializuara ne porte a ne vende te tjera qe mund te caktohen si “Punto apo zone franco”. Keto magazina mund te jene si te administratuara nga organizatat e ndryshme shqiptare , ashtu edhe prone e vete Shoqerise Anonime “Iliria Holding” Sh.A. ;**

**- Kryerjen e transaksioneve te ndryshme te tipit “Counter Trade” me mallra qe shkarkohen ne Republiken e Shqiperise , prekin kufirin e saj shteteror ose nuk e prekin fare ate ;**

**- Operacione tregtare ne rolin e komisionerit ;**

**- Kryerjen e punimeve ndertimore dhe prodhimin e materialit te ndryshem ndertimor ;**

**- Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e komunikacionit rrugor , ajror dhe ate detar ne vend dhe jashte ;**

**- Kryerjen e veprimtarise hoteliere dhe turistike ;**

**- Organizimin dhe hapjen e farmacive per qarkullimin e barnave dhe te medikamenteve si dhe perpunimi dhe pergatitja e tyre sipas receptures;**

**- Bashkepunimin ne veprimatri kulturore te ndryshme , duke perfshire organizim turnesh e shfaqjesh brenda e jashte shtetit, filmash artistike me pjesemarjen e aktoreve te huaj , duke perdorur ose jo mjediset e ndryshme artistike ose natyren shqiptare e shitje audio e video kasetash ne tregun e jashtem;**

**- Organizimin dhe hapjen e diskotekave dhe formave te tjera te zbavitjes per te rinj ;**

**- Kryerjen e veprimatrise grafike e botuese me celjen e shtypshkronjave , shtepive botuese , nxjerrjen dhe shtypjen e gazetave , botimin e librave , broshurave te ndryshme etj.**

## **Neni 9**

**Shoqeria ushtron veprimtarine e saj te percaktuar ne nenin 7 dhe 8 te ketij akti ne territorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie Shoqeria mund te cele deget dhe zyrat e saja te perfaqesimit ne vend dhe jashte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe legjislacionin e vendit te huaj ku celen ato.**

## **Neni 10**

**Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline dhe veprimtarine e saj ne perputhje me ndryshimet qe do te beje ne kete akt si akt themelues te saj.**

## **Neni 11**

**Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit , sigurise dhe rentabilitetit.  
Shoqeria i ka te gjitha autorizimet ne qarkullimin juridik me personat e trete.**

## **Neni 12**

**Per detyrimet e veta te krijuara ne qarkullimin juridik me personat e trete Shoqeria pergjigjet me te tere pasurine e saj.  
Aksionaret nuk pergjigjen per detyrimet e Shoqerise.**

## **III. KAPITALI I SHOQERISE**

## **Neni 13**

**Themeluesi i siguron mjetet - kapitalin ne te holla per krijimin dhe fillimin e punes se Shoqerise ne shumen prej 100.000 \$ USD si kapital themelor , te ndare ne 100 aksione te pruresit nga 1000 \$ secili aksion.**



#### **Neni 14**

**Pas celjes se llogarise xhiruese te Shoqerise prane Bankes Dardania - Tirane , Themeluesi eshte i detyruar qe mjetet ne te holla te percaktuara ne nenin 13 te ketij Vendimi , t'i kaloje menjehere ne kete llogari xhiruese.**

### **IV. ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 15**

**Me pelqimin e Themeluesit , Shoqerise mund t'i aderoje si bashkethemelues edhe ndonje person tjeter fizik apo juridik vendas apo i huaj , i cili , si aksionar , merr pjese ne drejtimin e Shoqerise dhe ndarjen e fitimit te saj ne perpjestim me kapitalin e investuar ne Shoqeri.**

#### **Neni 16**

**Themeluesi mban te drejten e pronesise ne mjetet - kapitalin e investuar per krijimin e Shoqerise.**

#### **Neni 17**

**Themeluesi nuk pergjigjet me pasurine e vet (vetjake ) per detyrimet e Shoqerise te cilen ai e ka fituar (realizuar) ne veprimtarine e tij me persona te trete.**

#### **Neni 18**

**Themeluesi mbart rrezikun per veprimtarine e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve- kapitalit te investuara me rastin e krijimit te Shoqerise.**

#### **Neni 19**

**Nese Themeluesi nje here e ka mbuluar humbjet e Shoqerise nga veprimtaria e saj ne nivelin e shumes se mjeteve - kapitalit te investuara me rastin e krijimit te saj , nuk eshte i detyruar te mbarte rrezikun per humbjet e metejshme.**



### **III. AKSIONET**

#### **Neni 20**

**Shoqeria emeton aksionet e pruresit ne shumen dhe menyren e percaktuar ne nenin 13 te ketij akti.**

#### **Neni 21**

**Shoqeria mund te emetoje , ne vend te aksioneve te pruresit, certifikata qe perfaqesojne nje apo me shume aksione.  
Aksionet apo certifikatat jane te firmosura nga nje anetar i administrates.**

#### **Neni 22**

**Aksionet emetohen si aksione te rendomta (te zakonshme).  
Aksionet mund te konvertohen ne aksione nominative me vendimin e Asamblese se Pergjithshme.**

#### **Neni 23**

**Cdo aksionar ka te drejte te nenshkruaje nje pjese te aksioneve te reja, ne perpjestim me numrin e aksioneve qe i posedon , ne qofte se me vendimin e rritjes se kapitalit nuk parashikohet ndryshe.**

#### **Neni 24**

**Aksionet , si letra me vlere , jane ne qarkullim dhe mund te shiten dhe te blihen ne vend dhe jashte.**



#### Neni 25

Aksionet e pruresit kalohen me dorezimin (tradicion) e tyre, ndersa ato nominative me indosament te plote, nese ne vete aksionin nuk eshte thene shprehimisht se nuk mund te kalohet.

#### Neni 26

Bleresi i aksioneve pas shitjes dhe dorezimit, perkatesisht indosamentit te plote, behet pronar i ri i aksioneve me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e pronarit te meparshem te aksioneve.

### IV . ORGANET DREJTUESE

#### Neni 26

Pervec Themeluesit, perkatesisht Presidentit dhe Drejtorit te Pergjithshem Shoqeria nuk ka organe te tjera, perderisa asaj, ne perputhje me kete vendim dhe statutin e saj, nuk i aderon ndonje person tjetër, si aksionar i ri.

#### Neni 27


Organet drejtuese te Shoqerise jane :

- Asambleja e Pergjithshme e Aksionareve
- Keshilli mbikqyres i cili perbehet nga Hajdin Sejdia, Ali Gosturani dhe Anton Eberli
- Komisioni i revizionit i cili do te kryesohet nga Kol Gjoni

#### Neni 28

Fusheveprimi, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese, te percaktuara ne nenin 27 te ketij vendimi, emerimi dhe shkarkimi i anetareve si edhe ceshtjet e tjera me rendesi per funksionimin e tyre, rregullohen me statutin e Shoqerise.

### V . ADMINISTRIMI I SHOQERISE



#### Neni 29

**Shoqeria zhvillon veprimtarine e vet administrative dhe financiare ne perputhje me kete Akt , Statutin e saj , si dhe legjislacionin shqiptar tjeter , qe rregullon funksionimin e Shoqerise Tregtare te huaja qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne Republiken e Shqiperise.**

#### Neni 30

**Themeluesi drejton veprimtarine e Shoqerise duke e mbeshtetur kete ne te drejten e tij te pronesise private me mjetet e investuara ne kete Shoqeri.**

#### Neni 31

**Themeluesi eshte njeheresh edhe President i Shoqerise me autorizime te pakufizuara. Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise e cakton Themeluesi me vendim te posacem. Drejtori perfaqeson Shoqerine para personave te trete brenda autorizimit te Themeluesit . Ne rastin kur Drejtori mungon apo eshte i penguar te ushtroje detyren e tij, ate e zevendeson punonjesi te cilin e cakton ai vete.**

#### Neni 32


**Themeluesi ka te drejte mbi fitimin qe realizon Shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj. Fitimi percaktohet me bilancin vjetor te Shoqerise.**

#### Neni 33

**Mbas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga Themeluesi , pjesa e fitimit neto qe i perket Themeluesit mund te transferohet lirisht jashte shtetit shqiptar pa asnje kufizim .**

### **VI . MARREDHENIET E PUNES**

#### Neni 34





**Marredheniet e punes ne Shoqeri , rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.**

**Mosmarreveshjet e punonjesve me Shoqerine zgjidhen nga Gjykata shqiptare. Kur pala ankuese eshte nje person i huaj, mosmarreveshja zgjidhet nga organi qe percaktohet ne kontraten e punes**

#### **Neni 35**

**Punonjesit nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te cilen e realizon Shoqeria gjate ushtrimit te veprimtrise se saj, nese ne kontraten e punes nuk percaktohet ndryshe.**

#### **Neni 36**

**Per punen e tyre ne Shoqeri , punonjesit marrin pagen e cila varesisht nga rezultatet e arritura ne pune , percaktohet ne kontraten e punes.  
Themeluesi e punonjesi ne kontraten e punes , mund te merren vesh qe punonjesit te huaj te Shoqerise nje pjese te pageses t'u jepet ne divize.**

### **VII. KOHEZGJATJA E VEPRIMTRISE SE SHOQERISE**

#### **Neni 37**

**Afati i veprimtarise se Shoqerise caktohet per nje periudhe kohe mbi 10 vjet te njepasnjeshme.**


#### **Neni 38**

**Aktiviteti i Shoqerise merr fund :**

- ne rastet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar**
- kur Themeluesi vendos qe t'i terheqe mjetet e investuara ne Shoqeri**
- kur te hapet procedura e likuidimit , perkohesisht e falimentimit.**

### **VIII . DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **Neni 39**



**Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes.**

**Neni 40**

**Ceshtje te cilat nuk jane rreguar me kete akt do te rregullohen me statutin e Shoqerise qe i bashkelidhet ketij akti si pjese perberese e tij.**


**Neni 41**

**Ky akt hyn ne fuqi dite n nxjerrjes dhe te nenshkrimimit nga Themeluesi.**

**Tirane , me 20.06.1997**

**T H E M E L U E S I**

**H A J D I N S E J D I A**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Hajdin Sejdia', written in a cursive style.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

---


Nr. 2014 Rep.

Nr. 436 Kol.

V E R T E T I M

Ne qytetin e Tiranes, sot me daten 20/Qershor 1997, u paraqit personalisht Z. SHEFQET DIZDARI, me profesion jurist, me banim ne Tirane Rr. Ded Gjo'Luli P.5 shk.I ap.7 madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i cili ne baze te Prokures se Pergjitheshme Nr.1168 date 11/Qershor 1997 leshuar nga Noteri KERNER WILD i Kantos nit OBWALDEN, neneshkroi ne emer te Z.HAJDIN SEJDIA aktin e Theme-limit dhe Statutin e Shoqerise Anonime ne pronesi private " ILIRIA HOLDING SH A " Tirane.

Une Noteria e vertetoj me firmen dhe vulen time.



## STATUT

### I SHOQERISE ANONIME NE PRONESI PRIVATE " ILIRIA HOLDING SH.A." - TIRANE

#### I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

##### Neni 1

Shoqeria Anonime ne Pronesi Private "Iliria Holding Sh.A." ne Tirane me kete Statut , ne perputhje me Aktin e Themelimit per krijimin e saj dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te Themeluesit dhe te punonjesve ne Shoqeri te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik , organizimin dhe objektin e veprimtarise se Shoqerise dhe ceshtjet e tjera me rendesi per punen e Shoqerise.

##### Neni 2

Shoqeria nga Neni 1 i ketij Statuti krijohet me mjete vetjake te Themeluesit me karakter Holding (Aksionar) dhe themeluesi i vetem i saj eshte Hajdin Sejdia, me banim ne Zvicer.

##### Neni 3

Shoqeria nga Neni 1 dhe 2 i ketij Statuti do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin : Shoqeria ne Pronesi Private "Iliria Holding Sh.A." - Tirane (me poshte e quajtur "Shoqeri").

##### Neni 4

Shoqeria ka Statutin e personit juridik te huaj.

*Av. Shqipri Dardani*  
Sy.



## Neni 5

Selia e Shoqerise eshte ne Rruga "Ded Gjonluli" Pll.5 Shk.1 Ap.7 , Tirane .

## Neni 6

Shoqeria ka vulen e saj.

Vula ka forme te rrumbullaket , me madhesi te zakonshme , rreth e perqark se ciles eshte shkruar teksti : " Shoqeria "ILIRIA HOLDING SA" Tirane Albania."

## Neni 7

Shoqeria ka intestimin e saj.


Intensimi ka forme te katerkendeshit kendedrejte , me madhesi te zakonshme, ne skajin e siperm te te cilit eshte shkruar teksti : "Shoqeria "ILIRIA HOLDING SA" Tirane Albania , ne mes eshte shkruar shenja "Nr" me nje vize e ne skajin e poshtem eshte shemuar nje vize me shenjen "19\_\_\_\_\_".

## II. OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### Neni 8

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj :

- Investime per objekte te rendesishme ne Republiken e Shqiperise ne fusha te ndryshme te ekonomise duke perfshire nxjerrjen, perpunimin dhe shitjen e mineraleve si edhe ne turizem etj , Shoqeria do te veproje jo vetem si investuese e drejtperdrejte , por edhe si ndermjetese per firmat e tjera te huaja. ne investime mund te perfshihen, sipas rastit, edhe "Engeneering- Konsalting and know how";
- Kryerjen e transaksioneve te ndryshme ne kuadrin e eksport-importit shqiptar per cdo mall (bujqesor, industrial, pasuri natyrore etj.) jo vetem per mallra te gatshme e lende te para, por edhe per mallra gjysem te gatshme qe kerkojne perpunim dhe shitje te metejshme ;

- 
- Sjelljen ne Republikën e Shqipërisë te mallrave te ndryshme te konsumit te gjere e industrial si ne rolin e shitesit, ashtu edhe me konsignacion. Per kete Shoqëria mund te cele njesi shitjeje te specializuara ne qytete te ndryshme te vendit , ku do te shitet me leke dhe me monedhe te huaj te konvertueshme ;
  - Tranzitimin e mallrave ne magazina te specializuara ne porte a ne vende te tjera qe mund te caktohen si “Punto apo zone franco”. Keto magazina mund te jene si te administratuara nga organizatat e ndryshme shqiptare , ashtu edhe prone e vete Shoqërisë Anonime “Iliria Holding” Sh.A. ;
  - Kryerjen e transaksioneve te ndryshme te tipit “Counter Trade” me mallra qe shkarkohen ne Republikën e Shqipërisë , prekin kufirin e saj shtetëror ose nuk e prekin fare ate ;
  - Operacione tregtare ne rolin e komisionerit ;
  - Kryerjen e punimeve ndertimore dhe prodhimin e materialit te ndryshem ndertimor ;
  - Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e komunikacionit rrugor , ajror dhe ate detar ne vend dhe jashte ;
  - Kryerjen e veprimtarise hoteliere dhe turistike ;
  - Organizimin dhe hapjen e farmacive per qarkullimin e barnave dhe te medikamenteve si dhe perpunimi dhe pergatitja e tyre sipas receptures;
  - Bashkepunimin ne veprimtari kulturore te ndryshme , duke perfshire organizim turnesh e shfaqjesh brenda e jashte shtetit, filmash artistike me pjesemarjen e aktoreve te huaj , duke perdorur ose jo mjediset e ndryshme artistike ose natyren shqiptare e shitje audio e video kasetash ne tregun e jashtem;
  - Kryerjen e veprimtarise grafike e botuese me celjen e shtypshkronjave , shtepive botuese , nxjerrjen dhe shtypjen e gazetave , botimin e librave , broshurave te ndryshme etj.

## Neni 9

Shoqëria ushtron veprimtari ne saj te percaktuar me kete Statut ne territorin e Republikës se Shqipërisë. Per kryerjen e kesaj veprimtarie Shoqëria mund te cele deget dhe zyrat e saja te perfaqesimit ne vend dhe jashte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe legjislacionin e vendit te huaj ku celen ato.





**Neni 10**

Shoqeria "Iliria Holding" Sh.A. , mund te ndryshoje emertimin, seline , formen dhe objektin e veprimtarise se saje ne vartesi te interesave te Themeluesit , por kurdohere duke e shoqeruar cdo ndryshim me vendime perkatese, te cilat pasqyrohen ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

**Neni 11**

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit , sigurise dhe rentabilitetit.  
Shoqeria i ka te gjitha autorizimet ne qarkullimin juridik me personat e trete.

**Neni 12**

Per detyrimet e veta te krijuara ne qarkullimin juridik me personat e trete Shoqeria pergjigjet me te tere pasurine e saj.  
Aksionaret nuk pergjigjen per detyrimet e Shoqerise.


**III. KAPITALI I SHOQERISE**

**Neni 13**

Mjetet ne te holla - kapitalin per themelimin e Shoqerise dhe fillimin e punes se saj, i siguron Themeluesi per krijimin e Shoqerise ne Pronesi Private "Iliria Holding Sh.A." - Tirane. Kapitali themelor i Shoqerise do te jete 100.000 \$ USD

**Neni 14**

Themeluesi siguron kapitalin themelor te Shoqerise te holla ne shumen 100.000 \$ USD , kapital qe do te sherbeje per fillimin e aktivitetit ekonomiko - financiar te saj .  
Ky kapital do te jete i ndare ne 100 aksione te prurresit dhe cdo aksion do te kete vleren 1000 \$ USD.





#### IV. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

##### Neni 15

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit per krijimin e Shoqerise "Tiria Holding Sh.A." - Tirane , me legjislacionin shqiptar dhe kete Statut.

##### Neni 16

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e investuara ne fondet e saj, me kredite e akorduara dhe me mjetet e tjera.

Shoqeria eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne varesi nga shuma e mjeteve te investuara ne fondin themeltar te Shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves.

##### Neni 17

Shoqeria percakton fondet e meposhtme :

- Fondin themelor
- Fondin rezerve

Per ushtrimin e veprimtarise se saj mund te percaktoje edhe fonde te tjera.


##### Neni 18

Fondi themelor i Shoqerise formohet nga mjetet e investuara te Themeluesit te Shoqerise dhe nga mjetet ne para te investuara nga persona te tjere.

Per mjetet e investuara ne fondin themelor, Themeluesi i leshon letrat perkatese me vlere ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

##### Neni 19

Shoqeria shfrytezon fondin themelor per kryerjen e puneve ne kuadrin e objektit te veprimtarise se saj per investime ne fondet e shoqerive te tjera ose te organizatave te tjera te cilat i ka formuar Shoqeria si dhe per te mbuluar rreziqet pas shfrytezimit te mjeteve te rezerves.







Fondin themelor Shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinime te tjera ne perputhje me aktet e politikes se saj afariste .

#### Neni 20

Fondi rezerve i Shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit qe Shoqeria e realizon gjate veprimtarise se saj qe percaktohet me nje vendim te vecante ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Mjetet e fondit rezerve jane mjetet vetjake te Shoqerise dhe shfrytezohen per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

Fondi rezerve mund te perdoret edhe per destinime te tjera ne perputhje me aktet e afarizmit te politikes se Shoqerise.

#### Neni 21

Per miratim te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga Themeluesi , pjesa e fitimit neto qe i perket Themeluesit mund te transferohet lirisht jashte shtetit shqiptar pa asnje kufizim.

### V. ORGANET E SHOQERISE

#### Neni 22

Themeluesi qeveris veprimtarine e Shoqerise duke e mbeshtetur kete ne te drejten e tij te pronesise private ne mjetet e investuara ne Shoqeri.

#### Neni 23

Themeluesi eshte njekohesisht edhe President i Shoqerise me autorizime te pakufizuara . Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise e cakton Themeluesi me vendim te posacem. Drejtori perfaqeson Shoqerine para personave te trete brenda autorizimeve te Themeluesit. Ne rastet kur drejtori mungon apo eshte i penguar te ushtroje detyren e tij, ate e zevendeson punonjesi te cilin e cakton ai vete.

#### Neni 24

Themeluesi ushtron keto pune :

- nxjerr planin dhe programin e zhvillimit dhe aktet e pergjithshme , vendimin per ndryshimin e emertimit , selise dhe veprimatrise se shoqerise ;
- jep udhezime dhe synime te nevojshme per punen e Drejtorit ;
- kujdeset per perpilimin cilesor dhe ne kohe te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor te cilet edhe i miraton ;
- nxjerr Statutin e Shoqerise dhe percakton bazat e politikes afariste ;
- vendos per ndarjen e fitimit ;
- kryen edhe pune te tjera nga veprimtara e Shoqerise ne perputhje me ligjin.

#### Neni 25

Drejtori qeveris veprimtarine e Shoqerise dhe e perfaqeson ate brenda autorizimeve te Themeluesit.

#### Neni 26

Drejtori i kryen te gjitha punet ne Shoqeri te cilat nuk jane kompetence e Themeluesit .

#### Neni 27

Pavec Themeluesit , perkatesisht Presidentit dhe Drejtorit Shoqeria nuk ka organe te tjera perderisa asaj ne perputhje me vendimin per krijimin e Shoqerise Anonime ne Pronesi Private "Iliria Holding Sh.A." - Tiranen dhe kete Statut nuk i aderon asnje person tjetet si aksioner i ri. Pas krijimit te kushteve te parashikuara ne paragrafin e 1 te ketij neni , Shoqeria formon oragnet e saj drejtuese.

#### Neni 28

Organet drejtuese te Shiqerise jane :

- Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve
- Keshilli mbikqyres i cili perbehet nga Hajdin Sejdia, Ali Gosturani dhe Anton Eberli
- Komisioni i Revizionit i cili do te kryesohet nga Kol Gjoni





## ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

### Neni 29

Asambleja e aksionareve eshte organi me i larte - vendimor i Shoqerise Aksionare.

### Neni 30

Asambleja e Aksionareve perbehet prej kryetarit dhe numrit te caktuar te anetareve .  
Kryetarin e cakton Asambleja e Aksionareve me propozimin e Aksionarit qe merr pjese me kapital me ta madh.

Numrin e anetareve te Asamblese se Aksionareve e cakton Asambleja e Aksionareve sipas pjese-marjtes se Aksionareve ne kapitalin themelor te Shoqerise.


### Neni 31

Asambleja e Aksionareve do te mbaje mbledhjen e pare te saj jo me vone se 30 dite nga data e regjistrimit te Shoqerise Aksionare.

### Neni 32

Asambleja e Aksionareve ushtron keto pune :

- nxjerr planin, programin e zhvillimit dhe aktet e pergjithshme , vendimin dhe ndryshimin e mertimit ,selise dhe veprimtarise se Shoqerise ;
- vendos per ritjen ose pakesimin e kapitalit themelor te Shoqerise ;
- jep udhezime dhe synime te nevojshme dhe orienton punen e administratorit te Shoqerise ;
- miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar vjetor te Shoqerise ;
- nxjerr Statutin e Shoqerise dhe percakton bazat e politikes afariste ;
- vendos per ndarjen dhe perdorimin e fitimit dhe per mbulimin e humbjeve dhe rreziqeve ;
- vendos per ndryshimin e formes se organizimit te brendshem te Shoqerise;
- vendos per pushimin- mbylljen e aktivitetit te Shoqerise
- emerone dhe shkarkon administratorin e Shoqerise ;
- emerone dhe shkarkon anetatret e (keshillit mbikqyres) komisionit te revizionit etj
- nxjerr rregulloren per punen e Asambles se Aksionareve ;
- drejton punet e tjera te rendesishme per afarizmin e Shoqerise .



### **Neni 33**

Asambleja e Aksionareve mund te funksionoje e vendose per te gjitha ceshtjet ne kompetencat e saj.

Mbledhjen e Asamblese Aksionare eshte e pranishme shumica e anetareve te saj.

### **Neni 34**

Asambleja Aksionare punon dhe vendos ne mbledhje me shumice te thjeshte votash.

### **Neni 35**

Asambleja e Aksionareve vendos me shumice votash, dhe cdo vote eshte e barabarte me nje aksion.

### **Neni 36**

Asambleja e Aksionareve cakton nje sekretar i cili nuk duhet te jete aksionar i Shoqerise .

### **Neni 37**

Menyra e punes organizimi dhe funksionimi i Asamblese se Aksionareve rregullohet me rregulloren e punes se saj qe e miraton Asambleja e Aksionareve ne mbledhjen e vet te pare.

## **ADMINISTRATORI**

### **Neni 38**

Shoqeria ka administratorin i cili per punen e tij i pergjigjet Asamblese se Aksionareve.





**Neni 39**

Administratori eshte organ ekzekutiv i Shoqerise qe mund te mos jete me doemos aksionar i Shoqerise.

**Neni 40**

Administratorin e emerom dhe e shkarkon Asambleja e Aksionareve me propozimin e aksionarit me kapital me te madh.

**Neni 41**

Mandati i administratorit perputhet me mandatin e Asamblese se Aksionareve dhe skadon ditën e skadimit te mandatit te Asamblese se Aksionareve.


**Neni 42**

Administratori kryen keto pune :

- administron dhe drejton punet perkatesisht veprimatrine e Shoqerise dhe afarizmin e saj,
- perfaqeson Shoqerine ndaj personave te trete ,
- pergjigjet per ligishmerine e punes se Asamblese Aksionare ,
- cakton personin te cilit i takon e drejta e firmes lidhur me Shoqerine dhe percakton vecorite e Shoqerise,
- propozon nxjerrjen e akteve nga kompetenca e Asamblese se Aksionareve te percaktuara ne nenin 31 te ketij Statuti,
- propozon organizimin e brendshem te Shoqerise dhe cakton numrin dhe strukturen e kualifikimit te punonjesve ,
- emerom dhe shkarkon shefat e sektoreve te Shoqerise,
- lidh kontrata dhe kryen veprime te tjera juridike brenda autorizimeve te Asamblese Aksionare ,
- kryen te gjitha punet ne Shoqeri te cilat sipas ketij Statuti nuk jane ne kompetence te Asamblese se Aksionareve dhe komisionit te revizionit.

**Neni 43**

Administratori per aktivitetin e tij merr nje shperblim vjetor fiks te pavarur nga rezultati financiar vjetor i Shoqerise te cilin e cakton Asambleja e ortakeve.



#### **Neni 44**

**Administratori mund te shkarkohet**

- me kerkese te tij ,
- kur aksionaret vertetojne se ai eshte pergjegjes per mosarritjen e rezultateve afariste te Shoqerise.
- ne rastet e tjera te parashikuara me ligj.

### **KOMISIONI I REVIZIONIT**

#### **Neni 45**

Shoqeria ka Komisionin e Revizionit .

Komisioni i Revizionit perbehet prej kryetarit dhe numrit te caktuar te anetareve.

Kryetarin e cakton Asambleja e Aksionareve me propozimin e aksionarit qe merr pjese ne kapitalin me te madh.

Numrin e anetareve te Komisionit te Revizionit e cakton Asambleja e Aksionareve sipas pjese marrjes se aksionareve ne kapitalin themelor te Shoqerise.

Kryetari dhe anetaret e Komisionit te Revizionit te Revizionit zgjidhen per nje kohe jo me shume se 2 vjet , te cilet mund te rizgjidhen.

#### **Neni 46**


Komisioni i Revizionit kontrollon veprimatrine e Shoqerise te degeve dhe te perfaqesive te sajk , sidomos ate financiare.

#### **Neni 47**

Kryetari dhe anetaret e Komisionit te Revizionit ne kryerjen e detyrave te tyre jane te pavarur.

#### **Neni 48**

Komisioni i Revizionit eshte pergjegjes per veprimtarine e tij perpara Asamblese se Aksionareve dhe eshte i detyruar t'i paraqese asaj cdo vit raportin per kontrollin e bera si dhe konkluzionet e bera per bilancet vjetore.





#### Neni 49

Pas perballimit te detyrimeve , taksave, tatimeve dhe shpenzimeve te tjera nga fitimi i Shoqerise dhe ndarjes se mjeteve per pagat e punonjesve Themeluesit i mbeten ne dispozicion fitimi neto.

#### Neni 50

Fitimi neto ndahet ne ,

- pjesen qe i perket Themeluesit,
- pjesen per zgjerimin e bazes materiale te punes (per zhvillimin e metejshem te Shoqerise) ,
- pjesen per shperndarje te punonjesve te zene ne pune ne Shoqeri nese nje shperndarje e tille eshte parashikuar ne kontraten e punes.

#### Neni 51

Fitimi neto per destinimet e parashikuara ne nenin 48 te ketij Statuti ndahet me vendim te vecante te Themeluesit.

#### Neni 52

Themeluesi mbart rrezikun per veprimtarine e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve kapitalit te investuara me rastin e krijimit te saj.

#### Neni 53

Nese Themeluesi nje here e ka mbuluar humbjet e Shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve , kapitalit , te investuara me rastin e themelimit te saj nuk eshte i detyruar te mbarte rrezikun per humbjet e metejshme.

#### Neni 54

Ne qofte se ne bilancin vjetor Shoqeria nuk del me fitim por me humbje , humbjet do te mbulohen ne perputhje me nenin 50 te ketij Statuti.



#### Neni 55

Nese mbas mbulimit te humbjeve me menyren e parashikuar ne nenin 51 te ketij Statuti , teprojne disa mjete shuma e tyre qe paraqet sihurues te kuaotes themeluese, nuk mund te shfrytezohen per shpermdarje ne perputhje me nenin 48 te ketij Statuti.

#### Neni 56

Ne qofte se humbjet e Shoqerise nuk mund te mbulohen nga mjetet e Themeluesit , te dhena me rastin e krijimit te Shoqerise ne perputhje me nenin 51 te ketij Statuti ndaj Shoqerise hapet procedura elikuidimit perkatesisht e falimentimit.

#### Neni 57

Aksionaret si bashkethemelues te Shoqerise , aksionet e tyre mund t'ja kalojne te treteve, te cilet , me marrjen e aksioneve , fitojne statutin juridik te aksionareve te deritanishem.

#### Neni 58

Aksionet mund ti kalojne te treteve vetem me pelqimin paraprak te aksionereve te tjere.

#### Neni 59


Kur aksionet e njerit aksionar si bashkethemelues ti kalojne te treteve me pelqimin e aksionareve te tjere si bashkethemelues , ky aksionar humb cilesine e aksionarit si bashkethemelues te shoqerise.

#### Neni 60

Njeri aksionar si bashkethemelues i Shoqerise mund t'i kaloje aksionet e veta aksionarit tjetër si bashkethemelues pa asnje kufizim.

#### Neni 61

Aksionaret bashkethemelues kane te drejte te parablerjes ekskluzive te aksionave, po qe se ndonjери prej tyre vendos qe ti shese aksionet e veta.  
Kur aksionaret nuk deklarohen per blerjen e aksioneve te aksionerit shites ky i fundit t'ia kaloje aksionet e veta te treteve.







## Neni 62

Shoqerise mund ti aderojne edhe aksionare te rinj me kushtet e parashikuara ne kete Statut.

## VII. ORGANIZIMI I BRENDSHEM I SHOQERISE

### Neni 63

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me anen e njesive organizative te saj. Punonjesit ne Shoqeri ne vartesi nga lloji dhe natyra e puneve cakton neper njesi organizative te Shoqerise. Njesite organizative jane sektoret. Keta dhe veprimtria e tyre caktohen me vendim te vecante te Themeluesit me propozim te drejtorit perkatesisht te Asamblese se Aksionareve me propozimin e administratorit.

### Neni 64

Sektoret nuk kane status te personit juridik dhe as autorizimin ne qarkullimin juridik per persona te trete.

### Neni 65

Ne sektor udheheq pergjegjesi (shefi) i sektorit.

Pergjegjesisin (shefin) e sektorit e emerone dhe e shkarkon drejtori i Shoqerise me pelqimin paraprak te Themeluesit , perkatesisht administratori i Shoqerise me pelqimin paraprak te Asamblese se Aksionareve.

Per punen e tij pergjegjesi (shefi) i sektorit pergjigjet para drejtorit te Shoqerise , perkatesisht administratorit te Shoqerise.

## VIII. MARREDHENIET E PUNES

### Neni 66

Marredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e Shoqerise ne pronesi private "Iliria Holding Sh.A." - Tirane , legjislacionin shqiptar dhe me kete Statut.

## Neni 67

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje ,

- kushtet dhe menyra e marredhenies se punes ,
- fillimi i punes se punonjesit dhe caktimi i tij ne vendin e punes ,
- koha e punes dhe caktimi i kohes se punes , puna e nates , puna jashte kohes normale te kohes se punes, puna ne diten e pushimit javor dhe festes zyrtare,
- mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes,
- pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve dhe punonjeseve per zbatimin e detyrave te punes ,
- pushimi i marredhenies se punes.

## Neni 68

Ne kontraten e punes caktohet paga e punes se punonjesit , shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

## IX. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

### Neni 69

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e puneve dhe zbatimin e detyrave me ndergjegje , ne menyre te ligjshme dhe profesionale.


### Neni 70

Drejtori , perkatesisht administratori eshte pergjegjes per kryerjen e puneve nga kompetencat e tij. Drejtori perkatesisht administratori dhe punonjesit e tjere udheheqes mbartin edhe pergjegjesine materiale per nxjerrjen e vendimeve joligjore dhe vendimeve me te cilat demtohet materialisht Shoqeria dhe Themeluesi i saj, perkatesisht aksionaret ne varesi nga ndikimi i tyre per nxjerrjen dhe ekzekutimin e vendimeve te tilla.

## X . SEKRETI I PUNES

### Neni 70

Sekret te punes paraqesin shkresat , materialet , perkatesisht aktet te cilat me ligj dhe dispozitat e tjera si dhe vendimet e nxjerra nga Themeluesi , perkatesisht Presidenti i Shoqerise dhe Asambleja e Ortakeve jane shpallur sekrete te punes.



#### **Neni 71**

Sekretin e punes jane te detyruar ta ruajne te gjithe punonjesit e Shoqerise.

#### **Neni 72**

Detyrat e ruajtjes se sekretit te punes vazhdon edhe pas nderprerjes se marredhenies se punes ne Shoqeri .

#### **Neni 73**

Te dhenat qe paraqesin sekret te punes mund ti kumtohen personave te trete vetem me lejen e Themeluesit , perkatesisht Presidentit te Shoqerise dhe Asamblese se Aksionareve.

### **XI . KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

#### **Neni 74**

Afati i veprimtarise se Shoqerise caktohet per nje periudhe kohe mbi 10 vjet te njepasnjeshme.

### **XII. MBYLLJA E SHOQERISE**

#### **Neni 75**


Shoqeria mbyll aktivitetin e saj ,

- ne rastet e percaktuara nga legjislacioni shqiptar ,
- kur Themeluesi perkatesisht aksionaret vendosin qe ti terheqin mjetet e investuara ne Shoqeri ,
- kur te hapet procedura e likujdimit perkatesisht e falimentimit.

### **XIII. DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **Neni 76**

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e rrethit ne Tirane.



### Neni 77

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij Statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen nxirret vete Statuti.

### Neni 78

Propozimet per ndryshimet dhe plotesimet e Statutit mund ti jape secili prej aksionareve te Shoqerise.

Propozimi nga paragrafi i pare i ketij neni jepet me shkrim .

Aksionaret e rinj si bashkethemelues te Shoqerise qe aderone ne Shoqeri jane te barabarte me Themeluesin ne realizimin e te drejtave dhe pergjegjesive te percaktuara ne vendimin per krijimin e Shoqerise Anonime ne Pronesi Private "Iliria Holding Sh.A." - Tirane dhe ne kete Statut.

### Neni 79

Diten e hyrjes ne fuqi e te aplikimit te dipozitave perkatese te ketij Statuti , qe kane te bejne me organet drejtuese te Shoqerise shfuqizohen dispozitat e po ketij Statuti qe rregullojne poziten te drejtat dhe detyrimet e Themeluesit si President dhe te Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise.


### Neni 80

Ky Statut hyn ne fuqi ditën e nxjerrjes nga Themeluesi.

Tirane me 20.06.1997

## THEMELUESI

HAJDIN SEJDIA



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERREVE TIRANE

Nr. 208 Rep.  
Nr. 437 Kol.

V E R T E T I M

Ne qytetin e Tiranes, sot me daten 20/Qershor 1997, u paraqit personalisht Z. SHEPQET DIZDARI, me profesion jurist, me banim ne Tirane Rr. Dësh Gjo'Luli P.5 shk.I ap.7 madhor, me notesi te plote per te vepruar, i cili ne baze te Prokurues se Pergjithshme Nr.1168 date 11/Qershor 1997 leshuar nga Noteri XERNER WILD i Kantonit OBWALDEN, neneshkroi ne emer te Z.HAJDIN SEJDIA aktin e theme- limit dhe Statutin e Shoqerise Anonime ne pronesi private " ILIRIA HOLDING SH A " Tirane.

Une Notaris e vertetoj me firmen dhe vulen time.

NOTERI  
Violeta Shlaku

PULLE TAKSE



V E R T E T I M

Ne qytetin e Tirenës, sot me datën 20/Qershor 1997, u paraqit personalisht Z. SHEFQET DIZDARI, me profesion jurist, me banim ne Tirane Rr. Dësh Gjok'Luji P.5 shk.I ap.7 meqhor, me notesi te plote per te vepruar, i cili ne beze te Prokures se Perqiftthesime Nr.1168 date 11/Qershor 1997 leshuar nga Noteri XERTNER WILD i Kantoni OBWALDEN, neneshkroi ne emer te Z.HAJDIBI SEJDIJA aktin e themelimit dhe Statutin e Shoqerise Anonime ne pronesi private " ILLIRIA HOLDING SH A " Tirane., si dhe kerkesen per gjykate.-

Une Notaria e vertetoj me firmen dhe vulen time.



NOTARI  
Gjeto Sejdija  
*[Handwritten signature]*